

Fjalimi_07.10.2016_Rrumbullakimi i projektit IPA 2011

Shkëlqesia e juaj, i nderuari Ambasador i Bashkimit Evropian, z.Samuel Zhbogar,

Të nderuar anëtarë të Këshillit të Agjencisë,

Të nderuar përfaqësues të Ministrisë së Financave,

Të nderuar përfaqësues të radiodifuzerëve dhe operatorëve,

Të nderuar përfaqësues nga Asseko,

Të nderuar mysafir,

Zonja dhe zotërinj,

Kam kënaqësi që jeni sot me ne, në evenimentin përmbyllës me të cilin rrumbullakohet Projekti IPA 2011 të titulluar "Sigurimi i pajisjes për monitorimin e përmbajtjeve mediatike që realizohet nga ana e Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale".

Ky projekt është me rëndësi të veçantë për Agjencinë, sepse përmes tij kemi blerë pajisje të re dhe sistem për monitorimin e përmbajtjeve mediatike. Agjencia në këtë mënyrë, në aspekt teknik e përsosi sistemin për incizimin, ruajtjen dhe kontrollimin e përmbajtjeve programore, të emetuara në radiot dhe televizionet. Njëkohësisht, tani mundësohet pranimi i sinjaleve nga të gjithë radiodifuzerët që kanë leje për realizimin e veprimtarisë së radiodifuzionit në territorin e Republikës së Maqedonisë, si dhe të sinjaleve nga të gjithë operatorët e rrjeteve publike të komunikimit elektronik në Republikën e Maqedonisë, këtu në selinë e Agjencisë. Kjo është mundësuar përmes transferimit të sinjaleve, nga tetë pikat e grumbullimit deri te pika qendrore e cila është e vendosur në Agjenci, e cila njëherë është edhe pikë e grumbullimit të largët për Shkupin.

Vlera e përgjithshme e pajisjes për monitorimin e përmbajtjeve mediatike është 839,608.00€, prej të cilave 75% janë siguruar me ndihmë financiare të Bashkimit Evropian, për çka në veçanti do të doja që ta falënderoj Delegacionin e Bashkimit Evropian në Republikën e Maqedonisë, për këtë projekt por gjithashtu edhe për projektet e realizuara gjatë viteve të kaluara, si dhe për përkrahjen e vazhdueshme që na e jep Delegacioni i Bashkimit Evropian në Republikën e Maqedonisë, gjatë punës së përditshme. Mjetet

tjera prej 25%, respektivisht 209,902.00€ janë siguruar me konfinancim nga buxheti i Agjencisë. Njëherë, shpreh falënderim edhe deri te kompania Asseko SEE SHPKNJP Shkup si dhe konsorciumit SALVIOL nga Lubjana, të cilët e implementuan softuerin dhe pajisjen për monitorim dhe pa ekspertizën dhe përvojën e të cilëve nuk do të realizohej ky projekt. Shpreh falënderimet edhe deri te Njësia qendrore për financim dhe lidhje të marrëveshjeve pranë Ministrisë së Financave dhe Sekretariatit për Çështje Evropiane, për bashkëpunimin e suksesshëm deri më tani.

Pajisja e re për monitorimin e përmbajtjeve mediatike për Agjencinë, siguron një incizim të vazhdueshëm 24 orës të programit të emetuar të shërbimeve programore të radios dhe televizioneve për të cilat Agjencia ka dhënë leje dhe incizime në kohëzgjatje prej së paku 90 sekondave për çdo shërbim programor, që është ritransmetuar përmes rrjetit të RRPKE së paku katër herë gjatë një dite, respektivisht gjatë 24 orëve. Dua të përmend se që nga fillimi i implementimit të këtij projekti Agjencia, realizoi edhe disa takime me operatorët kabllor, me qëllim të gjetjes së një zgjidhje më të lehtë dhe më të pranueshme për distribucionin e sinjalit deri te pikat pranuese të Agjencisë

Të nderuar të pranishëm,

Republika e Maqedonisë gjendet në prag të integritit në Bashkësinë Evropiane dhe atë Evropo-atlantike, bashkësinë e shteteve të lira dhe demokratike, me të cilat kemi vlera të ngjashme. Në këtë drejtim, zhvillimi dhe përsosja e trupave rregullator për mediumet, duhet te mbetet një sfidë dhe motiv shtesë për krijimin e partneriteteve dhe besimit të ndërsjellë me të gjitha palët e interesuara të shoqërisë.

Agjencia gjithmonë e ka kryer punën e sajë në mënyrë profesionale, të paanshme, dhe parimore, andaj kështu edhe do të vazhdojë të punësojë edhe në të ardhmen, pa marrë parasysh presionin që bëhet ndaj rregullatorit dhe ndaj të punësuarve. Të njëjtën e presim edhe nga mediumet, që në mënyrë objektive dhe të paanshme ta informojnë publikun e tyre për ngjarjet dhe ndodhitë aktuale.

Roli ynë i një rregullatori të pavarur dhe me profesionalizëm të lartë, vazhdimisht do ta plotësojmë edhe në të ardhmen. Në veçanti duke u kujdesur edhe për sigurimin e pluralizmit në sferën mediatike dhe lirinë e të shprehurit, si një prioritet kyç të çdo shoqërie demokratike.

Këtë herë jemi në fokusin e vëmendjes për shkak të monitorimit që realizohet nga Agjencia lidhur me Zgjedhjet e parakohshme parlamentare, të planifikuara për më 11 dhjetor 2016, e që në pajtim me rregullativën zgjedhore dhe marrëveshjen politike, filluan më 2 shtator. Deri në fillim të fushatës zgjedhore, lëndë e mbikëqyrjes janë 18 shërbime programore që emetojnë program në nivel shtetëror. Deri më tani, Agjencia ka publikuar dy raporte dhjetëditore për secilin prej shërbimeve programore nga ky monitorim. Sot do të publikohen edhe raportet për periudhën e tretë dhjetëditore deri nga 22 shtatori deri më 1 tetor 2016. Me propozim të Komisionit të përkohshëm për përcjelljen e informimit mediatic, deri më tani janë iniciuar 4 procedura për kundërvajtje para gjykatës kompetente.

Dua të potencoj se Shërbimi profesional i Agjencisë, gjithmonë me vetëdije dhe në mënyrë objektive e realizon monitorimin e informimit mediatic si dhe mbikëqyrjet tjera, sipas metodologjisë së harmonizuar me praktikat dhe rregullat botërore. Profesionalizimi dhe kompetencat e shërbimit profesional të Agjencisë, secili mund ti vlerësojë edhe përmes raporteve të monitorimeve, që mund të merren në ueb faqen tonë. Në këtë drejtim dua të shtoj se para ca kohe ishim në takim pune me Këshillin e medimeve elektronike të Republikës së Bullgarisë, ku nga ana e Agjencisë u realizua një punëtori lidhur me specifikat dhe realizimin edhe në praktik të monitorimin e medimeve gjatë proceseve zgjedhore në Republikën e Maqedonisë. Agjencia ka takime të vazhdueshme si dhe bashkëpunim edhe me trupat tjerë nga Ballkani dhe Evropa. Kemi pasur edhe takime studimore të rregullatorët spanjoll, portugez dhe francez në periudhën e kaluar, që janë realizuar gjithashtu me ndihmën dhe përkrahjen e Komisionit Evropian.

Për në fund, do të doja të theksoj se edhe më tutje mbetemi transparent për të gjitha proceset në Agjenci, përderisa sjellja profesionale me mediumet dhe të gjitha palët tjera, mbetet prioritet i yni edhe në të ardhmen.

Në fund do të doja që në veçanti të falënderoj të gjithë të punësuarit në Agjenci të cilët u angazhuan pa masë në realizimin e këtij projekti, Emilia, Lucija, Irena, Dragica, Arben, Argjent, Ognen, Shqipe dhe Jonçe Grozdanovski nga AKE. Kërkoj falje nëse kamë lëshuar dikënd pa dashje. Për në fund gjithashtu duha që të shpreh falënderim të vecantë edhe për kryetarin e Këshillit z. Llazo Petrushevski pa ndihmën e të cilit nuk do të përpilohej specifikat a teknike për këtë projekt.

Ju faleminderit.